

Prishtinë, 9 prill 2025

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit e Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 30.08.2023, dhe Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore – Edicioni 2024/2025 (“PG”), si dhe në bazë të Ankesës së KB Golden Eagle Ylli të datës 08.04.2025, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së (“KAA”), me datë 09.04.2025 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Golden Eagle Ylli e datës 08.04.2025;
- II. APROVOHET Ankesa e KB Golden Eagle Ylli e datës 08.04.2025 si e BAZUAR;
- III. NDRYSHOHET Vendimi i Komisionit të Garave të FBK-së me Nr. 53/2024/25 i datës 07.04.2025 përkitazi me ndëshkimin e shqiptuar ndaj lojtarit Imran Polutak.
- IV. Lojtari Imran Polutak i KB Golden Eagle Ylli ndëshkohet me gjobën prej €300.00 (treqind euro), në përputhje me Nenin 52.3 të PG.
- V. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Vendimit të Komisionit të Garave të FBK-së me Nr. 53/2024/25 i datës 07.04.2025.

A R S Y E T I M

Më datë 08.04.2025, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Golden Eagle Ylli të datës 08.04.2025 (tash e tutje “Ankesa”), e cila ka të bëjë me Vendimin e Komisionit të Garave të FBK-së me Nr. 53/2024/25 të datës 07.04.2025, (tash e tutje “Vendimi”), lidhur me incidentin e ndodhur gjatë lojës KB Proton Cable Prizreni—KB Golden Eagle Ylli e zhvilluar më 05.04.2025.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim më 09.04.2025 dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Golden Eagle Ylli, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga KB Golden Eagle Ylli dhe nga FBK.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia “Arbëria”, Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

Sipas kuptimit të KAA, KB Golden Eagle Ylli sfidon Vendimin e Komisionit të Garave me të cilin lojtari Imran Polutak i KB Golden Eagle Ylli ndëshkohet me 1 ndeshje moslojë dhe €1,000.00, bazuar në nenin 52.14 të PG. KB Golden Eagle Ylli kërkon ndryshimin e Vendimit në fjalë.

Thelbi i Ankesës së KB Golden Eagle Ylli është se dëshmitë, përkatësisht video inqizimi i incidentit në fjalë, tregojnë se lojtari Imran Polutak i KB Golden Eagle Ylli nuk ka marr pjesë në kacafytje ose rrahje, dhe se duke konstatuar se ai ka qenë i përfshirë, Komisioni i Garave ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, që njëheri, edhe e ka shtyer atë të aplikojë gabimisht të drejtën materiale.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, përfshi këtu edhe video inqizimin e incidentit në fjalë, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Golden Eagle Ylli ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit të Garave, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

Ne vijim, KAA merr parasyshë bazën juridike të cituar nga Komisioni i Garave në këtë rast. Neni 52.14 i PG thotë në pjesën relevante:

Pjesëmarrja në rrahje apo kacafytje e lojtarëve apo zyrtarëve të ekipeve kundërshtare, pa përfshirje të personave të tretë, para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes.

Në këtë dispozitë parashihet shqiptimi i gjobës prej €1,000.00 dhe 1 ndeshje moslojë.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

KAA ka shikuar videoinqizimin e incidentit dhe vënë re veprimet e të dy lojtarëve që janë ndëshkuar me Vendimin e Komisionit të Garave. Është e pakontestueshme se sjelljet e lojtarit Lenzell Smith JR të KB Proton Cable Prizreni janë të papranueshme, dhe bazë mjetueshme për ndëshkimin ndaj tij të shqiptuar nga Komisioni i Garave, në përputhje me Nenin 52.14 të PG.


Mirëpo, nga video inqizimi, KAA vlerëson se sjelljet e lojtarit Imran Polutak nuk ngriten në nivel të kacafytjes apo rrahjes, dhe veprimet e tij në incidentin në fjalë paraqesin shkelje të PG-së që më së shumti mund të vlerësohen si sjellje josportive dhe reagim ndaj kundërshtarëve dhe zyrtarëve (Pika A e Nenit 52), e nivelit të përshkruar sipas Nenit 52.3. Është e qartë se deri sa veprimet e lojtarit Imran Polutak mund të cilësohen si veprime apo sjellje josportive, ato nuk pasqyrojnë nga videoinqizimi se ngriten në nivel të Pikës B të Nenit 52, përkatësisht, pjesëmarrje në kacafytje apo rrahje.

Për më tepër, sjelljet e lojtarit Imran Polutak pas ndërhyrjes së gjyqtarëve ishin korrekte dhe të matura, dhe gjatë tërë kohës bindëse ndaj urdhërave të gjyqtarëve në fjalë.

Rrjedhimisht, KAA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni i Arbitrazhit:


Partin Pruthi
Anëtar


Korab R. Sejdiu
Kryetar


Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 09 prill 2025

Vendimi i dërgohet:

- KB Golden Eagle Ylli
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit të Arbitrazhit kanë të drejtë të ankesës të Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina